

NDIKIMI I PROJEKTIT:

Përmes krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm të bashkëpunimit, zhvillimit të instrumenteve analitike dhe metodologjike dhe forcimit të kapaciteteve të aktorëve institucionalë dhe të shoqërisë civile, projekti ka kontribuar në ndërtimin e një qasjeje më të koordinuar dhe sistematike kundër korrupsionit.

» Rezultatet e arritura:

54 organizata të përfshira në koalicion, mbi 100 anëtarë në platformën digjitale, më shumë se 3,500 përdorues të platformës, 151 përfaqësues të trajnuar, 15+ tryeza dialogu dhe 20+ produkte mediatike, dëshmojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërsektorial për forcimin e integritetit publik dhe përmirësimin e qeverisjes.



54



100+



3500



151



15+



20+




RRJETIANTIKORRUPSION.AL

ANËTARËSOHU DHE BËHU PJESË E RRJETIT



SKANO PËR TU
BASHKUAR ME NE



Financuar nga
Bashkimi Evropian



SHOQËRIA CIVILE KUNDËR KORRUPSIONIT NGA NJË SFIDË VENDASE NË NJË PËRGGJIGJE EVROPIANE

RRJETIANTIKORRUPSION.AL



SHOQËRIA CIVILE KUNDËR KORRUPSIONIT - NGA NJË SFIDË VENDASE NË NJË PËRGJIGJE EVROPIANE

Projekti "Shoqëria civile kundër korrupsionit nga një sfidë lokale në një përgjigje Evropiane!", i zbatuar nga Qendra ALTRI, synon të forcojë rolin e shoqërisë civile në promovimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike.

Në përputhje me prioritetet e integritetit evropian të Shqipërisë, projekti ka synuar rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në monitorimin e politikave publike, advokimin dhe dialogun institucional, si dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike për të parandaluar korrupsionin.

Projekti ka kontribuar në përmirësimin e proceseve politikbërëse dhe në forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe medias.



MEKANIZMA TË RINJ BASHKËPUNIMI KUNDËR KORRUPSIONIT

Një nga arritjet kryesore të projektit është krijimi i Koalicionit Kombëtar të Organizatave të Shoqërisë Civile kundër Korrupsionit, i përbërë nga 54 organizata nga e gjithë Shqipëria.

Platforma digjitale rjetiantikorrupsion.al, shërben si një hapësirë për koordinim, komunikim dhe shkëmbim informacioni mes aktorëve të angazhuar në luftën kundër korrupsionit.

Platforma numëron mbi 100 anëtarë aktivë, duke përfshirë:

- 54 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile,
- 23 përfaqësues të institucioneve publike, përfshirë Kuvendi i Shqipërisë, Avokati i Popullit dhe struktura të tjera përgjegjëse për politikën antikorrupsion
- mbi 20 përfaqësues nga sektori i biznesit, si dhe përfaqësues të medias

Platforma është aksesuar nga mbi 3,500 përdorues.

PRODUKTE ANALITIKE DHE INSTRUMENTE PËR PËRMIRËSIMIN E POLITIKAVE PUBLIKE

Komponent kyç i projektit ishte zhvillimi i produkteve analitike dhe metodologjike për të ndihmuar institucionet dhe aktorët e tjerë në identifikimin dhe adresimin e rreziqeve të korrupsionit.

Analiza mbi hetimin administrativ të korrupsionit. Ky studim ofron një vlerësim të kuadrit politik, ligjor dhe institucional që rregullon hetimin administrativ të korrupsionit në administratën publike. Analiza identifikon sfidat ekzistuese dhe jep rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të mekanizmave të hetimit dhe forcimin e integritetit institucional.

Metodologjia e Matjes së Perceptimit dhe Përvojave të Qytetarëve ndaj Korrupsionit.

Ky instrument është zhvilluar për të mundësuar matjen sistematike të perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve mbi korrupsionin në shërbimet publike.

Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit.

Ofron një kuadër praktik për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të korrupsionit në administratën publike. Aplikimi i saj ndihmon institucionet të identifikojnë vulnerabilitetet në procedurat administrative dhe të ndërmarrin masa parandaluese për përmirësimin e performancës dhe besueshmërisë së shërbimeve publike.

FORCIMI I KAPACITETEVE DHE DIALOGU INSTITUCIONAL

Për të mbështetur zbatimin e instrumenteve antikorrupsion, projekti ka organizuar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e dialogut ndërmjet aktorëve kryesorë.

NË TOTAL:

» 88

përfaqësues të institucioneve publike janë trajnuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut të korrupsionit

» 63

përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile janë trajnuar mbi monitorimin e politikave antikorrupsion dhe advokimin.

» 15

tryeza dialogu në nivel kombëtar dhe rajonal, që kanë shërbyer si platforma bashkëpunimi mes institucioneve publike, shoqërisë civile, biznesit dhe medias.

» 20

artikuj dhe intervista në media mbi çështjet e korrupsionit dhe rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies.